

FJALA E GUVNATORIT

Ju uroj mirëseardhjen në këtë takim të përvitshëm me Raportin Vjetor të Bankës së Shqipërisë, raport i cili ka qenë e mbetet një pasqyrë e plotë e aktivitetit dhe e rezultateve tona gjatë vitit.

Viti 2023 ishte një vit tjetër sfidues për ekonominë shqiptare. Rritja e ndjeshme e çmimeve në ambientin vendas dhe të huaj gjatë dy viteve të fundit, rritja e kostove të financimit, si dhe tensioni gjeopolitik, kanë qenë faktorë pengues për rritjen ekonomike dhe kanë testuar qëndrueshmërinë ekonomike dhe financiare të të gjitha vendeve të globit.

Megjithatë, edhe në këtë kontekst jo të favorshëm, ecuria e ekonomisë shqiptare ka qenë pozitive.

Vëllimi i aktivitetit ekonomik ka shënuar rritje dhe, së bashku me të, janë rritur punësimi e pagat. Njëkohësisht, bilancet financiare të bizneseve dhe familjeve kanë ardhur në përmirësim, borxhi publik dhe ai i huaj kanë ardhur në rënie, ndërsa treguesit kryesorë të shëndetit të sektorit bankar: likuiditeti, kapitalizimi dhe përfitueshmëria, kanë ardhur në përmirësim.

Paralelisht me to, inflacioni i çmimeve të konsumit shënoi një rënie të ndjeshme gjatë vitit, duke lehtësuar ndikimin negativ të tij në buxhetet familjare dhe duke reduktuar pasigurinë për bizneset.

Aktiviteti i Bankës së Shqipërisë ka pasur një kontribut të rëndësishëm në këtë tablo zhvillimesh.

Ne vijam të normalizojmë qëndrimin e politikës monetare gjatë vitit 2023, nëpërmjet rritjeve të normës bazë të interesit dhe në funksion të krijimit të premisave të nevojshme financiare për respektimin e objektivit tonë të stabilitetit të çmimeve. Megjithatë, shpejtësia e normalizimit u ngadalësua ndjeshëm gjatë vitit, duke u harmonizuar me reduktimin gradual të inflacionit, si dhe me kahun e politikës fiskale dhe forcimin e ndjeshëm të kursit të këmbimit. Sinjalet aktuale janë inkurajuese. Reagimi në kohën dhe në masën e duhur i politikës sonë monetare ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në reduktimin e inflacionit.

Bazuar në trendet aktuale, politika monetare duket se po përmbush me sukses misionin e saj: kthimin e shpejtë të inflacionit në objektiv me kosto minimale mbi aktivitetin ekonomik.

Gjithashtu, Banka e Shqipërisë ka vijuar punën për mbikëqyrjen dhe rregullimin e kujdesshëm të sektorit bankar, për zhvillimin e tregjeve financiare dhe të sistemeve të pagesave, si dhe për forcimin e rrjetave të sigurisë në sistem. Investimi i vazhduar që kemi bërë në vite ka forcuar rezistencën e këtij sektori ndaj goditjeve dhe i ka mundësuar atij të vijojë të plotësojë kërkesat për fonde të ekonomisë.

Në veçanti gjatë vitit të shkuar, sektori financiar shqiptar shënoi edhe tre arritje të rëndësishme: daljen e Shqipërisë nga lista e juridiksioneve nën monitorim të shtuar, njohur ndryshe si "lista gri" e vendeve sa i takon zhvillimit të infrastrukturës



për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftën ndaj terrorizmit; aplikimin në Autoritetin Bankar Evropian për njohjen e ekuivalencës me standardet evropiane të mbikëqyrjes dhe rregullimit bankar, si dhe nisjen e punës për anëtarësimin e Shqipërisë në Tregun Unik të Pagesave në Euro (SEPA), si pjesë integrale e agjendës së procesit të Berlinit.

Të gjitha këto arritje i hapin rrugë zhvillimit sasior e cilësor të gamës së instrumenteve financiare në ekonomi, uljes së kostove dhe rritjes së eficiencës së tyre, duke e afruar më shumë vendin me standardet më të mira bashkëkohore.

Së fundi, nuk mund të le pa përmendur dhe punën dhe rezultatet jo të pakta që kemi arritur në fusha të ndryshme të aktivitetit tonë, si furnizimin e ekonomisë me monedha e kartëmonedha cilësore, administrimin e rezervës valutore, mbështetjen e proceseve të integritetit evropian, rritjen e edukimit financiar të publikut, zgjerimin e dijeve mbi ekonominë dhe sistemin financiar shqiptar, si dhe dialogun e vazhdueshëm me partnerë të brendshëm e të huaj.

Në këtë kontekst, dëshiroj të veçoj dy projekte të rëndësishme të hartuara dhe miratuara nga Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2023: Strategjinë e Gjellbër Afatmesme 2023-2025 për "Administrimin dhe Mbikëqyrjen e Rreziqeve Financiare të Lidhura me Klimën në Sektorin Financiar" në bashkëpunim me Bankën Botërore, si dhe "Strategjinë e Bankës së Shqipërisë për Edukimin dhe Përfshirjen Financiare", e cila synon të promovojë edukimin financiar të publikut dhe të rrisë përfshirjen financiare të tij.

Të dashur lexues,

Puna e Bankës së Shqipërisë mbështetet në një vizion të qartë: përmbushjen e detyrave tona ligjore nëpërmjet adoptimit të praktikave më të mira të fushës së bankingut qendror. Ky vizion dokumentohet në Strategjinë Afatmesme të Bankës së Shqipërisë dhe vihet në zbatim nga një staf i talentuar dhe i përkushtuar.

Jam i bindur se kjo përqaasje, koherente dhe konsistente, do të na ndihmojë në përmbushjen e misionit tonë dhe adresimin me sukses të të gjitha sfidave të ardhshme.

Me respekt,

Gent Sejko
GUVERNATOR

